

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nëntor 2021 – Korrik 2022

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	01.11.2021	Informacion lidhur me naftëtarët e rafinerisë së Ballshit	11.11.2021	Dërguar informacioni mbi mënyrat për rivënie në punë të Kombinatit të Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN) në Ballsh, i cili është përdorur për përpunimin e naftës bruto dhe prodhimin e nënprodukteve të saj, nga të cilat një pjesë ishte e destinuar për tregun e brendshëm dhe një pjesë për eksport.	E plotë	Nuk ka
02	01.11.2021	Kërkohet informacion lidhur me kontratat dhe marrëveshjet e lidhura mes shtetit shqiptar dhe kompanisë Bankers Petroleum.	11.11.2021	Bashkëlidhur, i janë në dispozicion Marrëveshja Hidrokarbure midis Albpetroli dhe Kompanisë Bankers Petroleum Albania e miratuar me VKM nr. 477, date 16, 07, 2004 “Për Miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës, dhe ndryshuar me VKM nr. 251, datë 12.3.2009, dhe VKM nr. 723, date 02.11.2014.	E plotë	Nuk ka
03	01.11.2021	Kërkohet vënie në dispozicion të projektit dhe preventivit për Rrugën e Arbrit.	11.11.2021	Në respektim të nenit 50.1” Ruajtjen e Konfidencialitetit”, të Kontratës së Konkensionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë “Gjoka Konstruksion” sh.a “Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit “si dhe me qëllim informimin dhe në ruajtje të konfidencialitetit, i është vendosur në dispozicion vetëm planimetria gjurmë hortofoto e rrugës (ashtu siç është ndërtuar dhe ku i gjithë trupi i rrugës tashmë është vizualisht i dukshëm), sëbashku me vlerën e kontratës.	E kufizuar	Nuk ka
04	01.11.2021	Informacion mbi Landfillin e Sharrës për mbetjet inerte	02.11.2021	Deleguar Bashkisë Tiranë	E deleguar	Nuk ka
05	01.11.2021	Kërkohet të informohet mbi fazën në të cilën është aplikimi I licensës	02.11.2021	Është informuar kërkuesi se ky aplikim është në materialin e mbledhjes së radhës të	E plotë	Nuk ka

		së tij në studim e projektim		Komisionit te Posaçem te Dhenies se Licencave.		
06	02.11.2021	Kërkon të informohet mbi problematikën e hasur per aplikimin per rinovimin e kategorive të licencës individuale në studim e projektim	02.11.2021	Bashkelidhur i është vendosur në dispozicion lista e dokumentave qe duhet te ngarkohen në prortal në likun e mëposhtëm https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11138	E plotë	Nuk ka
07	03.11.2021	Krëkon të informohet mbi aplikimin për licencë individuale në studim e projektim dhe në mbikëqyrje e kolaudim.	03.11.2021	Është informuar kërkuesi se duhet të paraqitet pranë Sektorit të Monitorimit të Ljeve dhe Licensave në Ndërtim, Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi licenca e tij është miratuar.	E plotë	Nuk ka
08	07.11.2021	Kërkesë lidhur me stutusin në të cilin është kërkesa e tij për rimbursimin e shpenzimeve të transportit të kufomës	11.11.2021	Informuar kërkuesi se në vijim do të bëhet e mundur shlyerja e tij.	E plotë	Nuk ka
09	09.11.2021	Informacion mbi guroret në Republikë në Shqipërisë	24.12.2021	Dërguar informacioni mbi numrin e guroreve në bazë qarku, mbi guroret aktive si mbi masat e marra ndaj tyre.	E plotë	Nuk ka
10	10.11.2021	Informacion mbi plan-propozimin për vendosjen e paneleve diellore në stane	29.11.2021	Dërguar informacioni se, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, është duke punuar për diversifikimin dhe rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në kuadër të zbatimit efektiv të <i>Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018–2030</i> , miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.07.2018, <i>Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2018–2021</i> , të konsoliduar me VKM Nr. 580, datë 28.08.2019, i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi për fushën e energjisë dhe energjisë së rinovueshme në veçanti.	E plotë	Nuk ka

11	10.11.2021	Kërkon të informohet lidhur me projektin “Rehabilitimi i hekurudhës Tiranë – Durrës”.	22.11.2021	Informuar kërkuesi se, projekti që po implementohet, përfundon në zonën Mëzez, Tiranë, tek fusha e “Malaizianit”, konkretisht në zonën ku do të ndërtohet edhe Terminali i Transportit Publik të Autobusave të Tiranës.	E plotë	Nuk ka
12	11.11.2021	Informacion për mirëmbajtjen e urave në Republikën e Shqipërisë.	12.11.2021	Deleguar ARRSH.	E deleguar	Nuk ka
13	11.11.2021	Informacion mbi vijimin e procesit të verifikimit të kontratave koncesionare nga MI E dhe njoftimin për fillimin e procesit të zgjidhjes së kontratës për 27 subjekte që kanë rezultuar me shkelje të rënda.	16.11.2021	Informuar kërkuesi se bërja publike e informacionit mbi subjektet që kanë rezultuar me shkelje të rënda bie në kundërshtim me nenin 17, pika 2, shkronja ç, e ligjit nr.119/2014“Për të Drejtën e Informimit”, si dhe do të dëmtonte imazhin e subjekteve, për të cilat janë konstatuar shkelje të kushteve kontraktuale.	E kufizuar	Nuk ka
14	12.11.2021	Informacion mbi subjektet minerare që kanë derdhur garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit pas shfrytëzimit për nxjerrjen e mineraleve ne Pogradec.	13.12.2021	Dërguar informacioni mbi numrin e subjekteve minerare që zhvillojnë aktivitetet minerar në territorin e Bashkisë Pogradec si dhe fondin e garancisë financiare që derdhen subjektet minerare.	E plotë	Nuk ka
15	15.11.2021	Informacion mbi numrin e hidrocentraleve të ndërtuar nga viti 2014 deri në vitin 2020.	25.11.2021	Është informuar kërkuesja se kjo kërkesë është paraqitur edhe njëherë pranë MIE në datën 03.10.2021 përmes të cilës keni kërkuar të dhëna mbi hidrocentralet në vend për periudhën 2014-2021. Me shkresën Nr.7422 Prot datë 15.10.2021 “Kthim përgjigje tuajës për informacion” i është kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar, sipas fushës sonë të përgjegjësisë dhe e konsiderojmë të trajtuar këtë	E plotë	Nuk ka

				kërkesë.		
16	15.11.2021	Kërkon të informohet mbi kalueshmërinë e automjeteve në rrugën e Arbrit	7.12.2021	Infomuar kërkuesi se rruga është e kalueshme sipas Planit të Menaxhimit të Trafikut, <i>Tiranë-Klos: km 0+00-Hyrja e Tunelit të Murrizit-By Passi i Tunelit të Murrizit-Dalja e Tunelit të Murrizit-Fshati Fshat-Pika e lidhjes me Rrugën ekzistuese Kombëtare Sh6 (Segmentet rrugore RS1, RS2, RS3 pa Tunelin e Murrizit dhe Rruga lidhëse Fshati Fshat-Klos), si dhe të rrugëve Ura e Çerenecit Bllatë (RS6) dhe Maqellare-Bllatë.</i>	E plotë	Nuk ka
17	18.11.2021	Kërkon të informohet mbi tregtarët ambulante që ushtrojnë aktivitet në afërsi të rrugëve nacionale.	18.11.2021	Deleguar ARRSH.	E deleguar	Nuk ka
18	24.11.2021	Informacion mbi projektin e Portit të Durrësit.	20.12.2021	Informuar kërkuesi se, qeveria shqiptare në zbatim të Marrëveshjes “Mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, ratifikuar në Shqipëri përmes Ligjit 145/2020, si dhe në përputhje me Planin Kombëtar Sektoral për Transportin Detar dhe Infrastrukturën Portuale ka ndërmarrë një sërë veprimesh në përgjigje të interesit të shprehur pranë Agjencisë Shqiptare të Investimeve Strategjike, nga shoqëria “Symphony Real Estate Development sh.p.k”, për zhvillimin e Portit të Durrësit.	E plotë	Nuk ka
19	01.12.2021	Krëkon të informohet për statusin e aplikimit të tij për licensim për herë të parë në studim e projektim.	01.12.2021	Bashkelidhur i është vendosur në dispozicion lista e dokumentave që duhet të ngarkohen në prortal në likun e mëposhtëm	E plotë	Nuk ka

				https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11138		
20	07.12.2021	Informacion mbi projektin e Eko Parkut.	10.12.2021	Deleguar AKUM.	E deleguar	Nuk ka
21	07.12.2021	Informacion mbi marrëveshjet që MIE ka firmosur me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Republikës e Kosovës.	28.12.2021	Dërguar informacioni mbi marrëveshjet që Ministria Infrastruktures dhe Energjise së Shqipërisë ka firmosur me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures, në fushën e Transportit Hekurdhor dhe në fushën e Transportit Rrugor si, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 905, datë 18.11.2020, Më 26 Nëntor 2021, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës të Republikës së Kosovës mbi Bashkëpunimin në Fushën e Transportit Hekurdhor për realizimin në të ardhmen të lidhjes hekurudhore Durrës – Prishtinë si dhe Më datë 17.4.2019, me Vendimin nr. 229, Këshilli i Ministrave vendosi të miratojë Marrëveshjen, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit.	E plotë	Nuk ka
22	13.12.2021	Kërkon kopje të kontratës për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës (VIA) si dhe shtojcat e saj.	24.12.2021	Informuar kërkuesi se, Kontrata e lidhur midis MIE dhe bashkimit të operatorëve “Mabco Contruction SA of Matebex & YDA Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi & 2A Group sh.p.k”, për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit	E plotë	Nuk ka

				Ndërkombëtar të Vlorës, së bashku me shtojcat, është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ATRAKO dhe e aksesueshme në http://atrako.gov.al .		
23	13.12.2021	Informacion për flotën e avionëve që ka në dispozicion “Air Albania”	15.12.2021	Informuar kërkuesi se, Shoqëria “Air Albania” sh.p.k ka aktualisht të regjistruar në Regjistrin e Avionëve Civil Shqiptar <ul style="list-style-type: none"> • Avionin Tip Airbus, me Nr. Serie A319-132, me shenje regjistrimi ZA-BEL dhe certificate regjistrimi Nr. 792; • Avionin Tip Airbus, me Nr.Serie 320-232, me shenje regjistrimi ZA-BBC dhe certificate regjistrimi Nr. 705. 	E plotë	Nuk ka
24	13.12.2021	Informacion mbi dhënien me shfrytëzim të Portit të Shëngjinit	14.12.2021	Dërguar informacion mbi Portin e Shëngjinit, i cili është një port i hapur për të gjithë operatorët vendas dhe të huaj. Operatorët ekonomik te Kosovës kanë lehtësira si në Portin e Durrësit si dhe në atë të Shëngjinit,	E plotë	Nuk ka
25	17.12.2021	Informacion mbi punimet në rrugën Porto Romano Durrës (Loti 3)	17.12.2021	Deleguar ARRSH.	E deleguar	Nuk ka
26	21.12.2021	Informacion mbi ndertimin e centraleve eolike ne Gadishullin e Karaburunit.	11.1.2022	Informuar kërkuesi se projektet eolike në Karaburun janë të pajisur vetëm me Miratim Paraprak nga MIE dhe këto subjekte kanë të drejtë vetem të bëjnë studime më të thelluara përse i përket potencialit energjetik, që nuk përfshin asnjë punim ndërtimor.	E plotë	Nuk ka

				Këto subjekte nuk do pajisen me Miratim Përfundimtar, nëse nuk paraqesin një dokumentacion mjedisor të miratuar nga institucionet përgjegjëse mjedisore në vend		
27	24.12.2021	Informacion në lidhje me disa prej subjekteve që operojnë në territorin e fshatrave Terbac, Vranisht, Kallarat, Kuc, për lejet minerare.	31.12.2021	Dërguar informacioni për subjektet që operojnë në territorin e fshatrave Terbac, Vranisht, Kallarat, Kuc, për lejet minerare, lidhur me llojin e mineralit, vendodhjen e objektit si dhe pagesat në lidhje me garancinë e rehabilitimit dhe të investimit.	E plotë	Nuk ka
28	27.12.2021	Kërkon të informohet në lidhje me përcaktimin e tarifave ose të ndryshuara për transportin e udhëtarëve nga qarku Dibër drejt qarqeve të tjera si kontrollet e ushtruara kontrolle tek kompanitë ose shoqëritë e transportit të udhëtarëve për linjat e licencuara ndërqytetase që operojnë në qarkun e Dibrës.	24.1.2022	Indormuar kërkuesi se çmimi i biletave të udhëtimit në transportin ndërqytetas është i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 66, datë 7.2.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, dhe përcaktohet në bazë të distancës në kilometra. nga ana e Inspektorëve të autorizuar të Task Forcës, kryhen kontrolle të rastësishme në terren. - Në kontrollin e ushtruar nga to nuk është konstatuar asnjë shkelje ose parregullsi nga operatorët e linjave respektive si: Dibër-Tiranë; Bulqizë-Tiranë; Klos-Tiranë.	E plotë	Nuk ka
29	28.12.2022	Informacion lidhur me problemin e furnizimit me ujë të mullirit, në fshatin Marinaj në Librazhd, si pasojë e ndërtimit të HEC “Kalis”.	28.1.2022	Informuar kërkuesi se, nga ana jonë, me marrjen e dëgjimit të saj, menjëherë kemi kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për çështjen objekt pretendimi. Në kuadër të monitorimit të kontratës, AKBN, pas verifikimit të situatës, ka informuar MIE se, nga komunikimi në terren me ankuesin dhe mbajtësin e	E plotë	Nuk ka

				<p>miratimit, ky i fundit është shprehur i gatshëm të bëjë ndërhyrjet e nevojshme lidhur me problemin e furnizimit me ujë të kanalit të mullirit.</p> <p>Më pas, nga ana jonë është kërkuar përsëri verifikim të gjendjes nga AKBN, të cilët pas verifikimit dhe takimit në terren me ankuesin dhe mbajtësin e miratimit, janë shprehur se ende nuk ishte zgjidhur problemi i furnizimit me ujë të kanalit të mullirit. Në lidhje me këtë problematikë, kemi bërë me dije shoqërinë duke kërkuar marrjen e masave nga ana e tyre për zgjidhjen e saj.</p>		
30	30.12.2021	<p>Informacion mbi kontratën e koncesionit/PPP mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompanisë “Gjoka Konstruksion” “Për përmirësimin, operimin dhe ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”, të miratuar me VKM nr. 180, datë 28.3.2018.</p>	12.01.2022	<p>Informuar kërkuesi se ky projekt do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e transportit lokal të njerëzve dhe do të bëhet një nyje kryesore që lidh kryeqytetin e Shqipërisë dhe vendin fqinj Maqedoninë e Veriut. Për këtë arsye, ky projekt mund të çojë drejt rritjes ekonomike të dy vendeve dhe do të ndikojë në zhvillimin rajonal. Ky projekt mund të shfrytëzojë në mënyrë me eficientë burimet ekzistuese të tokës, të përmirësojë efikasitetin e transportit, të minimizojë aksidentet rrugore brenda rajonit të projektit dhe në mënyrë efektive të rrisë sigurinë rrugore. Prandaj, punimet e rehabilitimit të këtij projekti mund të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë rajonale.</p>	E plotë	Nuk ka
31	05.01.2022	<p>Informacion mbi projektin e Rrugës së Arbrit.</p>	27.01.2022	<p>Informuar kërkuesi se, në zbatim të Kontratës së miratuar me VKM nr.180, datë 28.03.2018, për miratimin e Kontratës Koncesionit/PPP,</p>	E plotë	Nuk ka

				"Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", ju informojmë se vlera e kontratës është 33,600,000,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu, Kompania koncesionare është duke zbatuar kontratën sipas projektit të zbatimit të miratuar për të përbushur të gjitha afatet kontraktuale, për përfundimin e plotë të punimeve ndërtimore.		
32	05.01.2022	Informacion mbi përfundimin e ndërtimve të disa rrugëve kryesore.	07.01.2022	Deleguar Autoritetit Rrugor Shqiptar.	E deleguar	Nuk ka
33	05.01.2022	Informacion mbi furnizimin e Republikës së Kosovës me datat 31 Dhjetor dhe 01 Janar nga Shqipëria.	04.02.2022	Për datat 31 Dhjetor dhe 01 Janar KESH i ka dhënë Korporatës Elektroenergjitike të Kosovës sasinë prej 7,680 MËh, bazuar mbi kërkesën e KEK. Nevoja për furnizim me energji të Republikës së Kosovës në datat e kërkuara mund të saktësohet vetëm nga entet që ushtrojnë veprimtarinë e furnizimit në këtë vend. Referuar të dhënave të bëra publike nga ZRRE, konsumi mesatar familjar ditor në Republikën e Kosovës për muajin Dhjetor është rreth 8,870 MËh/ditë	E plotë	Nuk ka
34	06.01.2022	Informacion për kontratën kocesionare /PPP"Për ndërtimin, përmësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit".	27.01.2022	Informuar kërkuesi se, në zbatim të Kontratës së miratuar me VKM nr.180, datë 28.03.2018, për miratimin e Kontratës Koncesionit/PPP, "Për Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit", ju informojmë se vlera e kontratës është 33,600,000,000 lekë pa tvsh. Gjithashtu, Kompania koncesionare është duke zbatuar kontratën sipas projektit të zbatimit të miratuar për të përbushur të gjitha	E plotë	Nuk ka

				afatet kontraktuale, për përfundimin e plotë të punimeve ndërtimore.		
35	07.01.2022	Informacion mbi ndryshimet që ka pësuar Kodi Rrugor për aksidentet rrugore përgjatë 2 viteve të fundit.	08.02.2022	Gjatë 2 viteve të fundit Kodi Rrugor ka pësuar ndryshime me ligjin Nr. 63/2021, date 7.5.2021 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr. 8378, date 22.7.1998 “ Kodi Rrugor i Republikës së Shqiperisë”, i ndryshuar. Ndryshimet synojnë të bëjnë të aplikueshme zhvillimet e përditësuara në transportin rrugor, një parandalim më efikas të aksidenteve rrugore dhe ndjekjen e tendencave pozitive të legjislacioneve rrugore të vendeve të BE-së. Konkretisht, janë ripërcaktuar afatet dhe frekuenca e kryerjes se kontrollit teknik te mjeteve rrugore ne perpythje me direktiven Evropiane 2014/45/EC “Mbi kontrollin teknik periodik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre”, jane forcuar kerkesat per pergatitje te drejtuesve te mjeteve pasi humbin piket e lejedrejtimit, jane ashpersuar masat administrative ndaj shkelesve ndaj sjelleve me te rrezikshme per aksidentet, eshte rishikuar rregulli i sjelljes te drejtuesve ndaj kembesoreve dhe veprimit ne rast aksidenti. Gjithashtu, jane lehtesuar procedurat e shqyrtimit te masave administrative. Materialet didaktike qe perdoren per edukimin e drejtuesve te mjeteve duhet te jene me pare te miratuara per te siguruar nje cilesi me te mire. Jane pershtatur rregullat e levizjes se nje mjeti bashkekohor si patina elektrike. Investimet e zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të	E plotë	Nuk ka

				Transportit Rrugor do të orientohen në drejtim të programeve që synojnë përmirësimin e sigurisë rrugore dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës.		
36	11.01.2022	Informacion në lidhje me projektin e ri për Portin e Durrësit	11.01.2022	Deleguar Autoritetit Portual Durrës.	E deleguar	Nuk ka
37	11.01.2022	Kërkon të informohet për kryerjen e pagesës për licensë individuale në studim e projektim / mbikëqyrje e kolaudim.	11.01.2022	Informuar kërkuesi se, pagesa duhet të kryehet përmes sistemit e-albania.	E plotë	Nuk ka
38	13.01.2022	Informacion rreth transaksioneve të kryera për Inceneratorin e Fierit dhe të Tiranës.	01.02.2022	Është informuar kërkuesi për transaksionet që janë kryer për Inceneratorin e Fierit si dhe informuar se MIE nuk është autoriteti që kryen pagesa për kontratën Inceneratorit të Tiranës.	E plotë	Nuk ka
39	17.01.2022	Kërkon kopje të kontratës koncesionare për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës.	25.01.2022	Kontrata e lidhur midis MIE dhe bashkimit të operatorëve “Mabco Contruction SA of Matebex & YDA Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi & 2A Group sh.p.k”, “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës”, së bashku me shtojcat, është e publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ATRAKO dhe e aksesueshme në http://atrako.gov.al .	E plotë	Nuk ka
40	17.01.2022	Informacion mbi pritshshmëritë në sektorin e energjisë për vitin 2022.	03.02.2022	Informuar kërkuesi se, Viti 2022 është një vit atipik, përse i përket sektorit të energjisë, duke qenë se Europa po përjeton një nga krizat më të rënda të energjisë. Cmimet e energjisë në bursa kanë prekur nivele të paimagjinueshme më parë, që sigurisht kanë impaktuar edhe sektorin e energjisë në Shqipëri.	E plotë	Nuk ka

				<p>Gjithsesi periudhat e krizave mund të shërbejnë edhe si katalizator për zhvillime të rëndësishme në sektor.</p> <p>Prioriteti numër një i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është sigurimi i plotë i nevojave të furnizimit me energji në Shqipëri. Ky detyrim me ndryshimet e fundit ligjore i ka kaluar shoqërisë publike KESH Sh.A., që ka detyrimin e plotë për sigurimin e energjisë elektrike për klientët fundorë. Ministria ka vendosur fokus të rëndësishëm në diversifikimin e burimeve prodhuese në vend. Në vitin 2022, priten zhvillime të rëndësishme në prodhimin e energjisë nga dielli, duke filluar nga fillimi i punimeve të ndërtimit të projektit 140 MË të Karavastasë në pranverë. Gjatë vitit 2022, MIE do vijojë me mbështetjen e projekteve nga dielli dhe era. Gjatë vitit 2022, cmimet e energjisë priten të vazhdojnë të larta. Bursa hungareze përcakton pritshmërinë në vitin 2022 në nivelin 182.53 Eur/MËh. Qeveria ashtu sic edhe gjatë vitit 2021, do jetë e gatshme për të ndërhyrë me mekanizma financiar, në rast se do jetë e nevojshme për sigurimin e furnizimit të plotë me energji në vend.</p> <p>Projekte të rëndësishme që MIE po punon dhe që ka pritshmëri të lartë për avancimin e procedurave janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përfundimi i studimit të plotë të Fizibilitetit për Tec Vlora, nga shoqëritë amerikane Exxon dhe Excelerate. Në bazë të studimit të fizibilitetit do vijohet me negocimin e kontratës me këto shoqëri;	
--	--	--	--	---	--

				- Përfundimi i plotë i fizibilitetit të Hec Skavicës dhe vijimi I negocimit të kontratës me shoqërinë Bechtel.		
41	17.01.2022	Informacion mbi transferimin e shërbimve të përpunimit të mallrave nga Porti i Durrësit në “Porto Romano”.	07.02.2022	<p>Këshilli Kombëtar i Territorit, me Vendimin nr.1, datë 14.10.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale” ngarkoi Autoritetet Portuale, që të marrin masat e nevojshme për sigurimin e ekspertizës më të mirë kombëtare apo ndërkombëtare lidhur me hartimin e planeve të përdorimit dhe administrimit të hapësirave portuale.</p> <p>Më konkretisht, vendimi e ngarkoi Autoritetin Portual Durrës që të merrte masat për hartimin e dokumenteve tekniko-ligjore që do ta orientojnë Autoritetin Portual për zhvillimin e operacioneve portuale, shërbimeve dhe investimeve në infrastrukturën detare dhe tokësore të terminaleve përkatëse, në përputhje me zonat e përcaktuara në Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale (Porto Romano dhe Durrës). Masterplani Strategjik, bazuar dhe në eksperiencat e ngjashme në disa vende të Bashkimit Evropian, në zonën e Mesdheut perëndimor, Europës Hanseatike dhe Detit Baltik, ka parashikuar një plan zhvillimor të dyfishtë:</p> <p>- Nga njëra anë ndërtimin, përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës portuale të Autoritetit Portual</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Durrës në Porto Romano, ku do të transferohen progresivisht aktivitetet e transportit detar të mallrave,</p> <p>- Dhe nga ana tjetër ridimensionimin progresive të facilitetit aktual të Portit të Durrësit në funksionet e një marine turistike dhe hapësire urbane me shërbime elitare për turizmin dhe pasagjerët.</p>		
42	21.01.2022	Informacion mbi lejet koncesionare që janë dhënë me object HECE nga viti 2005 – 2022.	08.02.2022	Informuar kërkuesi se, në zbatim të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të gjitha kontratat koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vend gjenden të publikuara në faqen zyrtare online të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).	E plotë	Nuk ka
43	24.01.2022	Informacion mbi raportet dhe vlerën e investimit në pikat për ofrmin e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve.	10.03.2022	<p>Lidhur me këto raporte theksojmë se, në zbatim të kontratës së koncesionit të lidhur ndërmjet Ministrisë dhe SGS në shtator 2009, neni 21 “Konfidencialiteti”, ku përcaktohet që informacioni për palët e treta, nuk mund të jepet pa marrë miratimin e palës tjetër, na detyron të zbatojmë dhe të jemi korrekt me këtë kërkesë të nenit 21 të kontratës.</p> <p>Konkretisht nenin 21.1 “Konfidencialiteti”, të kësaj kontrate citohet se:</p> <p>21.1 “Palët duhet të konsiderojnë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionit e tjera në lidhje me projektin, qofshin tregtare, teknike, juridike dhe nuk duhet t’ia bëje të ditur një pale të tretë, të gjithë apo pjesë të dokumentit apo informacionit pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kësaj</p>	E kufizuar	Nuk ka

				kontrate”.		
				Për sa më sipër vlerësohet që, dhënia e informacionit është në kundërshtim me dispozitën e konfidencialitetit të kontratës. Në këto kushte, ndodhemi në rastin e kufizimit të informacioni të kërkuar, pasi konsiderohet konfidenciale, kjo në respektim dhe të pikës 1/b të nenit 17 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.		
44	26.01.2022	Kërkon listën e detajuar përsa i përket akteve rrugore në Shqipëri të caktura si “njolla të errëta”.	31.01.2022	Deleguar ARRSH.	E deleguar	Nuk ka
45	31.01.2022	Kërkon të informohet mbi projektin “Rijetësimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër, Këlcyrë.”	01.02.2022	Deleguar Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.	E deleguar	Nuk ka
46	07.02.2022	Informacion në lidhje me ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumen Shalë	24.02.2022	Informur kërkuesi se ndërmjet MIE dhe subjektit për Qëllime të Vecanta “3 Poëer Shala” shpk, krijuar nga Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Cinar – San Hafriyat Nakliyat Turizm Sanayi Ve Ticaret LTD sti” shpk, shala Energy PLC shpk dhe “Falak Properties LLC” shpk (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës “BOT” me Nr. 703 Rep., Nr 314/3 Kol., datë 04 prill 2018 për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumen Shalë.	E plotë	Nuk ka
47	08.02.2022	Informacion mbi kontratën e rrugës së Arbrit	14.02.2022	Rruga e Arbrit, mbështetur tek grafiku i punimeve të projektit bazë, është parashikuar se koha e ndërtimit zgjat 44 muaj dhe koha e mirëmbajtjes dhe operimit është 112 muaj. Me	E plotë	Nuk ka

				rishikimin e projektit për "Alternativën B, Tuneli i Murrizit – Hyrja Tiranë", për këtë vepër, ku punimet u pezulluan për 17 muaj, do të jetë e nevojshme koha shtesë deri në përfundimin e plotë me cilësi dhe siguri të tij.		
48	08.02.2022	Kërkon kopje të kontratës koncesionare për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës.	11.02.2022	<p>Kontrata e lidhur midis MIE dhe bashkimit të operatorëve "Mabco Construction SA of Matebex & YDA Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi & 2A Group sh.p.k", "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës", së bashku me shtojcat, është e publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ATRAKO dhe e aksesueshme në http://atrako.gov.al.</p> <p>Sqarojmë se, kjo është kontrata e vetme e lidhur në 20 prill 2021, midis MIE dhe bashkimit të operatorëve "Mabco Construction SA of Matebex & YDA Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi & 2A Group sh.p.k", "Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës".</p> <p>Më poshte gjeni linkun në të cilin është e publikuar kjo kontratë:</p> <p>http://atrako.gov.al/?page_id=659&contract=1260</p>	E plotë	Nuk ka
49	09.02.2022	Informacion për hapjen e Urës së Tapizës.	10.02.2022	Deleguar ARRSH.	E deleguar	Nuk ka
50	09.02.2022	Informacion për projektin "Marina & Jahtet e Durrësit".	21.02.2022	Qeveria shqiptare, në përputhje me Planin Kombëtar Sektoral për Transportin Detar dhe Infrastrukturën Portuale, i cili ka përcaktuar zhvendosjen	E plotë	Nuk ka

				e aktivitet tregtare te Autoritetit Portual Durres per ne portin e Porto Romanos si dhe ne zbatim te Marrëveshjes “Mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, ratifikuar në Shqipëri përmes Ligjit 145/2020, ka ndërmarrë një sërë veprimesh në përgjigje të interesit të shprehur pranë Agjencisë Shqiptarë të Investimeve Strategjike (AIDA), nga shoqëria “Symphony Real Estate Development sh.p.k”, për zhvillimin e Portit të Durrësit. Shoqëria Symphony Real Estate Development sh.p.k, NUIS M11726006H, zotërohet plotësisht nga subjekti “Symphony Invest Limited”, që në vetvete është pjese e grupit të shoqërive të Z. Mohamed Alabbar, i cili prej vitësh është drejtues në kompaninë EMAAR.		
51	22.02.2022	Kërkon ti vihet në dispozicion kopje e urdhrit të 25 janar 2019, për ndërprerjen e koncesionit Thumanë – Kashar.	14.04.2022	Bashkëlidhur i është në dispozicion Urdhri nr. 42, datë 25.01.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për ndërprerjen e procedurës për dhënen e koncesionit /Partneritetit Publik Privat për Projektin e rrugës Thumanë-Fushë Krujë-Vorë-Kashar”.	E plotë	Nuk ka
52	24.02.2022	Informacion mbi studimin e fizibilitetit për HEC Skavicën.	25.02.2022	Deleguar KESH	E deleguar	Nuk ka
53	25.02.2022	Informacion mbi funksionimin e linjës së internjeksionit së Shqipëri – Kosovë në Dhjetor 2020.	28.02.2022	Deleguar KESH	E deleguar	Nuk ka
54	28.02.2022	Informacion për “Korridorin Blu”, projekti që transformon infrastrukturën në aksin	14.04.2022	Korridori Adriatiko-Jonian (AIC) është një projekt strategjik i Ballkanit dhe i gjithë Evropës Juglindore.	E plotë	Nuk ka

		rrugor Muriqan – Milot – Tiranë.		<p>Përfundimi i tij do të lidhë Evropën Qendrore dhe Italinë Veriore me Gadishullin Ballkanik me Detin Jon nëpërmjet Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Greqisë. Korridori Adriatiko-Jonian shtrihet përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe Jonit, nga Trieste në Itali deri në Kalamata në Greqi. Gjatësia totale e parashikuar e Autostradës është rreth 1550 km, nga të cilat 296 km janë në Shqipëri.</p> <p>Ndërtimi i AIC në territorin shqiptar është një projekt prioritar për Qeverinë Shqiptare, si pjesë e planeve të zhvillimit rajonal të Traktatit të Komunitetit të Transportit (TCT), të përfshira në Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planin e Veprimit 2016-2020, është pjesë e Planit Kombëtar të Transportit Rishikimi i Dytë (ANTP3) dhe është pjesë shumë e rëndësishme e Paketës sonë projekteve prioritare kombëtare.</p>		
55	28.02.2022	Informacion për kontratën koncesionare e formës BOT për ndërtimin e Kaskadës së Hec mbi lumen Shushicë.	18.03.2022	<p>Bashkëlidhur i është vendosur në dispozicion kopja e shtesës së kontratës koncesionare nr 9 rep/nr4/1kol, dt 04.01.2019, “Për disa ndryshime në kontratën e koncensionit e formës BOT për ndërtimin e Kaskadës së HEC mbi lumen Shushicë”;</p> <p>Përsa i përket pikës së dytë, nëse ka vendimarrje lidhur me konfliktin (mbivendosjen) e projektit të ndërtimit të Hidrocentralit KUC me projektin "Furnizimi me ujë i zonës së Himarës, programi i</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>ujësjellësëve Rural IV”, ju bëjmë me dije se: Nuk ka konflikt (mbivendosje) midis projektit Hidrocentrali “Kuç” dhe projektit "Furnizimi me ujë i zonës së Himarës, programi i ujësjellësëve Rural IV”, pasi me shkresën Nr. 3285/2 Prot., datë 10.11.2021, Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë lejen e ndërtimit (të zbardhur), konkretisht vendimin nr. 17, datë 12.07.2019 “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për objektin, “Ndërtimi i Hidrocentralit “Kuç” në rrjedhën e sipërme të pellgut ujebledhës të Lumit të Shushicës, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë” me subjekt zhvillues Shoqërinë “Age Kuç”, të cilën po e përcjellim bashkëlidhur.</p>		
56	05.03.2022	Informacion mbi ngritjen e cmimit të naftës.	18.03.2022	<p>Informuar kërkuesi se, cmimet e naftes dhe nenprodukteve te saj perفشire edhe karburantet ne Republikën e Shqipërisë janë te liberalizuara dhe percaktohen nga tregu.</p> <p>Kostoja e karburanteve perbehet nga kuotimi i nenprodukteve te naftes ne bursen nderkombetare sikunder eshte “PLATTS”, sistemi fiskal ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë dhe kostot qe lidhen me transportin, magazinimin dhe administrative te shoqerive te tregëtimit me shumice dhe ato te tregëtimit me pakice.</p>	E plotë	Nuk ka
57	10.03.2022	Kërkon të njihet me tabelën ku janë të pasqyruar distancat midis qyteteve në Shqipëri.	11.03.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka

58	11.03.2022	Informacion për Inceneratorin e Tiranës.	15.04.2022	Referuar afateve te miratuara, punimet e ndërtimit sipas grafikut te punimeve për kontratën e koncesionit te nënshkruar midis Ministrisë se Mjedisit dhe shoqërisë koncesionare Integrated Energy BV SPV, duhet te përfundojnë ne vitin 2025. Kontrata e Koncesionit se bashku me anekset, është e publikuar ne faqen e ATRAKO, pranë Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë, si institucioni përgjegjës për publikimin e bazës se te dhënave për te gjitha kontratat e koncesionit ne Republikën e Shqipërisë.	E plotë	Nuk ka
59	16.03.2022	Informacion mbi listën e subjekteve që janë pajisur me Miratim Përfundimtar dhe paraprak për ndërtimin e impianteve fotovoltaike dhe eloike.	06.04.2022	Bashkëlidhur i është vendosur në dispozicion lista e subjekteve që janë pajisur me Miratim Përfundimtar dhe paraprak për ndërtimin e impianteve fotovoltaike dhe eloike, si dhe informuar kërkuesi se me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 580, datë 28.08.2019 “Për Miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019-2020” është miratuar plani i cili gjendet në Fletoren Zyrtare.	E plotë	Nuk ka
60	24.03.2022	Informacion mbi kontrollin e subjekteve që ushtojnë veprimtarinë e tyre në fushën e hidrokarbureve.	24.03.2022	Deleguar ISHTI	E deleguar	Nuk ka
61	24.03.2022	Informacion për projektin “Rikualifikimi i Unazës Lindore për lotet 4, 5 dhe 6”.	24.03.2022	Deleguar ASHSH	E deleguar	Nuk ka
62	25.03.2022	Informacion mbi kufizimin me energji elektrike në disa akse kryesore.	10.05.2022	Bashkëlidhur i është dërguar tabela e detajuar me akset rrugore në të cilat është kufizuar energjia elektrike si	E plotë	Nuk ka

				dhe tabela e sasisë të energjisë të përfituar nga reduktimi i ndrcimit në akset rrugore.		
63	28.03.2022	Informacion mbi realizimin dhe vënen në punë të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura.	28.03.2022	Deleguar AKUM	E deleguar	Nuk ka
64	28.03.2022	Informacion mbi inceneratorin e Elbasanit.	19.05.2022	Nga të dhënat që disponon MIE, në inceneratorin e Elbasanit është prodhuar energji elektrike. Informacionin mbi sasinë e energjisë të prodhuar në inceneratorin e Elbasanit e merrni pranë OSHEE. Nga informacioni që disponon MIE, deri në datën 13.12.2021, datë në të cilën impianti ka kaluar nën Administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, është kryer trajtimi i mbetjeve në impiantin e trajtimit të Mbetjeve Elbasan.	E plotë	Nuk ka
65	28.03.2022	Informacion mbi procedurën për të shfrytëzuar minierat e hekur – nikelit në Kukës.	11.04.2022	Zona minerare Nr. 364/4, objekti Leshnica, Qarku Kukës, lloji mineralit hekur - nikel, veprimtaria shfrytëzim, është zone e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 127, datë 25.02.2013 “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar të vitit 2013”. Kjo zone është shpallur ne procedure konkurruese me Ftesen per Oferte nr. 9283 prot. date 24.12.2021, publikuar ne Buletinin e APP nr. 192 date 31.12.2021.	E plotë	Nuk ka
66	30.03.2022	Kërkon të njihet me marrëveshjen që ka realizuar qeveria shqiptare me TAP (Trans Adriatic Pipeline).	11.04.2022	Bashkëlidhur i janë vendosur në dispozicion marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si më poshtë vijon:	E plotë	Nuk ka

				<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji nr. 104/2013 2. Ligji nr. 116/2013 3. Ligj nr. 53/2017 4. Vendimi nr. 233, datë 23.3.2017 i Këshillit të Ministrave publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr. 63 , datë 29.03.2017. 5. Ligj nr 45/2018 publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr. 111, datë 30.07.2018. 		
67	04.04.2022	Informacion mbi projektin e Portit të Durrësit .	11.04.2022	Deleguar APD dhe AIDA	E deleguar	Nuk ka
68	06.04.2022	Informacion mbi kontratën për prodhimin e energjisë elektrike nga dy anijet në portin e Vlorës.	11.04.2022	Deleguar KESH	E deleguar	Nuk ka
69	08.04.2022	Informacion mbi xhiron vjetore të disa subjekteve minerare	15.04.2022	Deleguar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	E deleguar	Nuk ka
70	13.04.2022	Informacion mbi përfundimin e punimeve për rrugën e Arbrit.	20.05.2022	Informuar kërkuesi se, punimet që po kryhen për rrugën e Arbrit, po zbatohen sipas projektit dhe pritet që punimet e mbetura të përfundojnë brenda afateve kontraktuale.	E plotë	Nuk ka
71	19.04.2022	Informacion mbi projektin e Parkut Fotovoltaik të Spitallës.	03.06.2022	Informuar kërkuesi se, projekti i Spitallës është në fazën e plotësimit të kushteve paraprake të kontratës. Pritet dorëzimi i tokës në dispozicion të shoqërisë Voltalia. Ndërkohë shoqëria po përgatit dokumentacionin e nevojshëm teknik.	E plotë	Nuk ka
72	19.04.2022	Informacion mbi lejet koncesionare që janë dhënë me object HECE nga viti 2005 – 2022.	09.05.2022	Informuar kërkuesi se, në zbatim të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të gjitha kontratat koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve në vend gjenden të publikuara në faqen zyrtare online të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).	E plotë	Nuk ka
73	20.04.2022	Informacion në lidhje me statusin e Minierës	07.05.2022	Informuar kërkuesi se, në lidhje me statusin e minierës	E plotë	Nuk ka

		së Perlatit.		Perlat , leja minerare nr. 990/1, zotëruese e të cilës ka qenë shoqëria “Ballkan Resources” sh.p.k është revokuar me vendimin e revokimit nr. 8422 prot. datë 08.06.2018		
74	20.04.2022	Informacion mbi anijet në Triportin e Vlorës të marra me qira që do të prodhojnë energji elektrike	22.04.2022	Deleguar KESH	E deleguar	Nuk ka
75	22.04.2022	Kopje të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 48, datë 30.01.2019	30.05.2022	Bashkelidhur i është vendosur në dispozicion, Urdhri nr. 48, datë 30.01.2019, "Për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 822, datë 07.10.2015, nga burimet hidrike të Energjisë".	E plotë	Nuk ka
76	27.04.2022	Informacion mbi përfundimin e punimeve në rrugën e Arbrit	16.05.2022	Informuar kërkuesi se, punimet që po kryhen për rrugën e Arbrit, po zbatohen sipas projektit dhe pritet që punimet e mbetura të përfundojnë brenda afateve kontraktuale.	E plotë	Nuk ka
77	04.05.2022	Informacion për punimet në aksin rrugor Kardhiq - Delvinë	04.05.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka
78	04.05.2022	Informacion për rrugën e lagjes “Malmer”, Borizanë.	09.05.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka
79	09.05.2022	Informacion mbi projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International”, për forcimin e sigurisë kibernetike””.	15.06.2022	Informuar kërkuesi se, arsyeja kryesore e kësaj marrëveshje është përmirësimi i sistemit të sigurisë kibernetike në institucionet shtetërore në disa aspekte të caktuara të tij, me qëllim mbrojtjen e të dhënave elektronike që administrojnë dhe përpunojnë këto institucione. Kompania e sigurisë kibernetike “Jones group international” do të ofrojë ekspertizën e saj në Shqipëri, për të gjitha sistemet elektronike për të mbrojtur databazat me të dhënat e	E plotë	Nuk ka

				qytetarëve.		
80	11.05.2022	Informacion mbi inceneratorin e Elbasanit	19.05.2022	Informuar kërkuesi se, Aktualisht, Inceneratori i Elbasanit administrohet nga Agjencia Shtetërore e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.	E plotë	Nuk ka
81	11.05.2022	Informacion mbi rrugën Qendër – Fushë Krujë.	01.06.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka
82	20.05.2022	Informacion për projektin 100 fshatrat.	01.06.2022	Deleguar FSHZH	E deleguar	Nuk ka
83	20.05.2022	Informacion për rikonstruksionin e rrugëve në Bashkinë Vlorë dhe Selenicë.	01.06.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka
84	24.05.2022	Informacion për shpronësimin nga VKM nr.236, datë 30.03.2016.	01.06.2022	Deleguar ASHSH	E deleguar	Nuk ka
85	31.05.2022	Informacion për tunelin e Murrizit.	29.06.2022	Informuar kërkuesi se, sipas projektit bazë të miratuar, koha e ndërtimit ka qenë 44 muaj, por për shkak të problematikave gjeologjike, gjeoteknike të nëntokës dhe pranisë së ujrave nëntokesor, koha e ndërtimit është zgjatur dhe për këtë arsyeje vonesat janë të justifikuara .	E plotë	Nuk ka
86	07.06.2022	Informacion për projektin Durrës Yacht & Marina	10.06.2022	Deleguar APD	E deleguar	Nuk ka
87	10.06.2022	Informacion për Triportin e Vlorës	20.06.2022	Deleguar KESH	E deleguar	Nuk ka
88	13.6.2022	Informacion mbi Vendimin nr. 650, datë 02.10.2019, i Këshillit të Ministrave “Për sigurimin e ndërtimeve”	08.07.2022	Informuar kërkuesi se, Vendimi nr. 650, datë 02.10.2019, i Këshillit të Ministrave “Për sigurimin e ndërtimeve”, regullon marrëdhëniet ndërmjet ndërtuesit/zhvilluesit/investitorit dhe bleresit duke shoqëruar kontratën e blerjes me një kontratë sigurimi me afat 10-(dhjetë-) vjeçar me përfitues blerësin/blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, në zbatim të pikës 9, të nenit 42, të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të	E plotë	Nuk ka

				<p>ndryshuar. Ky mekanizem ka si qëllim mbrojtjen juridike dhe financiare të bleresit/blerësve dhe palëve të treta për shkak të detyrës që mund të ndodhin në objektet ndërtimore, pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë, duke përfshirë edhe dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin për shkak të tokës ose për defekte të ndërtimit të tilla si mosvlerësim i saktë i inxhinierëve zbatues të ndërtuesit ose materialit cilësisë së dobët i përdorur në këtë ndërtim, të cilat mund të shkaktojnë shembje të plote ose të pjesshme të ndërtimit, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda</p>		
89	28.06.2022	Informacion mbi landfillin e Sheristës në Vlorë	30.06.2022	Deleguar AKUM	E deleguar	Nuk ka
90	04.07.2022	Informacion për urat në Republikën e Shqipërisë	05.07.2022	Deleguar ARRSH	E deleguar	Nuk ka

